



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1592/ 10 prot.

Datë 01/08/2024

V E N D I M
Nr. 1000/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshmik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01/08/2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Health & Light*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedura e Hapur*”, me REF-01574-04-16-2024, me objekt Loti 1 “*Mirëmbajtja “full risk” e pajisjeve mjekësore të prodhuesit Philips*”, me fond limit 23,108,800 (njëzet e tre milion e njëqind e tetë mijë e tetëqind) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 07.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Shkodër.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*MSE*” SHPK në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Ankimues:

Operatori ekonomik “*Health & Light*” SHPK me NIPT L42231011L, me adresa: Rruga “Themistokli Germenji”, Nd. 11, H. 4, Ap. 4, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Spitali Rajonal Shkodër.
Adresa: Rruga “Kole Heqimi”, Shkodër.

Subjekti i interesuar: Operatori ekonomik “MSE” SHPK me NIPT L82001005A dhe me adresë Rruga “Diga e Liqenit”, ZK. 8270, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.04.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedura e Hapur*”, me REF-01574-04-16-2024, me objekt Loti 1 “*Mirëmbajtja “full risk” e pajisjeve mjekësore të prodhuesit Philips*”, me fond limit 23,108,800 (njëzet e tre milion e njëqind e tetë mijë e tetëqind) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 07.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Shkodër.

II.2. Në datën 07.05.2024 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 31.05.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “MSE” SHPK	18.000.000	lekë	kualifikuar
2. “Health & Light” SHPK	23.102.400	lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 31.05.2024, operatori ekonomik “*Health & Light*” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

Data e deklaratave (pika 2.3.3, 2.3.4, 2.3.7) te DST-se nuk eshte data e zhvillimit te procedures (07.05.2024)

Deklarata (pika 2.3.7 e DST-se) jo e plote.

II.5. Në datën 11.06.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “*Formular Njoftim Fituesi Paraprak*” për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 31, datë 18.06.2024.

II.6. Në datën 14.06.2024, nëpërmejt sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është dorëzuar ankesa me nr. A/2023/4219 dhe me nr. 1592/2024 prot, datë 14.06.2024 e operatorit ekonomik “*Health & Light*” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike si dhe kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “*MSE*” SHPK, si më poshtë vijon:

Ceshtja nr. 1

AK pretendon/refuzon oferten tone me justifikimin se Data e deklaratave 2.3.3; 2.3.4; 2.3.7 te DST-se, nuk eshte data e zhvillimit te procedures (07.05.2024). Ne shtojcen e publikuar ne SPE ne date 24.04.2024, AK ka ndryshuar nje nga kriteret e kualifikimit, pikerisht piken 2.3.3

duke e bere si me poshte: “OE te paraqesi nje deklarate qe merr persiper kryerjen e mirembajtjes te tipit Full Risk sipas specifikimeve teknike per pajisjet objekt prokurimi dhe te gjithë aksesoreve te cilat jane te lidhura me pajisjen”.

Gjithashtu ne Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, pika 2.3.4 kerkohet: “OE te paraqesin nje deklarate qe merr persiper zevendesimin e pjeseve te kembimit dhe konsumit te cilat do te jene origjinale ose ekuivalente dhe ne perputhje me ato te perdorura fillimisht dhe te garantuara nepermjet certifikimit Ce ose FDA dhe qe perfshihen ne vleren e kontrates. Garancia e pjeseve te kembimit do te jete per nje periudhe jo me pak se nje vit nga momenti i levrimit”.

Ne permbushje te ketyre dy kriterëve, ne kemi paraqitur deklaratat bashkengjitur, hartuar dhe ngarkuar ne SPE ne date 03.05.2024 ku deklarojme per piken 2.3.3 ekzaktesisht sipas kerkeses se AK qe marrim persiper kryerjen e mirembajtjes te tipit Full Risk sipas specifikimeve teknike per pajisjet objekt prokurimi dhe te gjithë aksesoreve te cilat jane te lidhura me pajisjen.

Dhe duke deklaruar per piken 2.3.4 ekzaktesisht sipas kerkesave te AK, qe marrim persiper zevendesimin e pjeseve te kembimit dhe konsumit te cilat do te jene origjinale ose ekuivalente dhe ne perputhje me ato te perdorura fillimisht dhe te garantuara nepermjet certifikimit Ce ose FDA dhe qe perfshihen ne vleren e kontrates. Garancia e pjeseve te kembimit do te jete per nje periudhe prej nje viti nga momenti i levrimit.

Datat qe ne i kemi vendosur deklaratave, jane datat qe ne kemi pergatitur keto deklarata dhe jo data e hapjes se tenderit. Skualifikimi i ofertes tone per kete iarsyeë eshte i pa bazuar ne ligj dhe i pa bazuar ne kerkesat e kualifikimit te parashikuara nga vete AK. Kjo per disa arsye:

Se pari: kjo procedure prokurimi ishte Procedure e Hapur. Referuar LPP neni 42, “Procedura e Hapurë”, pika 5 e tij, parashikon: Për procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të ulët dhe të lartë monetar, afati për pranimin e ofertave është jo më pak se 20 ditë nga shpallja e njoftimit të kontratës dhe, në rast se ofertat paraqiten me mjete elektronike, ky afat mund të shkurtohet me 5 ditë. Pra vete ligji i njeh operatoreve ekonomik te drejten e tyre qe per nje periudhe prej X ditesh te drejten qe te pregatisin ofertat e tyre. Deklarata qe une pergatis duhet te mbaje daten ekzakte qe une pergatis dekaratat dhe dhe jo daten e tenderit. Per Autoritetin Kontraktor eshte e rendesishme permbajtja e deklarates nese eshte permbushur apo jo dhe jo data qe une pergatis deklaraten.

Se dyti: Ne vete permbajtjen e deklaratave jane permendur te gjitha specifikat e kesaj procedure, pra ne deklarata eshte permendur, Referenca e procedures per te cilen referohet kjo deklarate, objekti i procedures dhe fondi limit i procedures duke mos lene vend per dyshime nese keto deklarata jane apo jo per kete procedure prokurimi. Pra AK ka patur mundesine e bindjes qe keto deklarata jane pikerisht per kete procedure pavaresisht dates se pergatitjes se deklaratave nga ana jone.

Se treti: nuk ekziston asnjë detyrim ligjor i parashikuar në legjislacionin e Prokurimit Publik për të detyruar operatorët ekonomik që në vetedeklarimet e tyre të cilat dorëzohen për të përmbushur kriteret e kualifikimit të vendosin datën e hapjes së tenderit dhe jo datën e përgatitjes së vetedeklarimit.

Për këto arsye, pretendimi i KVO nuk qëndron

Lidhur me pretendimin e KVO që Deklarata (pika 2.3.7 e DST-se) është jo e plotë, ju bëjmë me dije se pretendimi juaj është i padrejtë dhe i pa bazuar në ligj dhe në e plotësojmë këtë kriter, kjo për disa arsye:

Se pari: pjesë e specifikimeve teknike të procedurës ishte edhe kërkesa: Operatori ekonomik duhet të bëjë inspektimin e sigurisë së pajisjeve mjeksore të pakten tre here në muaj dhe të përpilojë procesverbalin i cili të firmoset nga komisioni i kolaudimit dhe inxhinieri i operatorit ekonomik. Kërkesë të cilën në e kemi pranuar sipas deklaratës së paraqitur 2.3.3. pra thelbi është përmbushur.

Se dyti dhe me e rëndësishmja, në kemi paraqitur shtojcën 9, ku në pjesën e tretë të saj: Deklaratë në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të të objektit të kontratës kemi deklaruar se “Health & Light” plotëson të gjitha specifikimet teknike sic udhëzohet në dokumentat e tenderit dhe që marrim përsiper të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e levrimit përcaktuar nga AK.

Se treti: KVO nëse do të kishte paqartësi e kishte të gjithë hapësirën ligjore referuar Nenit 92 të Shqyrtimit të ofertave të ligjit nr. 162/2020, të kerkonte sqarime në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri. Pra KVO nuk e ka shfrytëzuar këtë hapësirë ligjore dhe ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 Për Prokurimin Publikë.

Pra, sic edhe provuam deri tani, “Health & Light” ka përmbushur me të gjitha menyrat kriterin e kualifikimit të kerkuar dhe refuzimi i një oferte me një vlerë me të ulet se fondi limit dhe që përmbush të gjitha kriteret ligjore dhe teknike të parashikuara nga vete AK, është krejtësisht në kundërshtim me frymën e legjislacionit të Prokurimit Publik.

Për këto arsye, pretendimi i KVO nuk qëndron.

Në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “MSE” Shpk, kërkojmë skualifikimin e këtij operatori pasi që OE nuk plotëson kriteret e kualifikimit të parashikuara në LPP dhe DST. Me poshtë po rëndësishmë arsye të duhet të skualifikohet ky OE:

OE MSE, nuk ka plotësuar sipas kërkesave ligjore shtojcën 9 “Formularin Përmbledhës të Vetedeklarimitë” përkatësisht Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit ku në paragrafin e tretë kërkohet: Personi/personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose

mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. Nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjecare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. Nisur nga verifikimi i bërë online dhe informacioni i marrë në ekstraktin e këtij OE nga QKB, rezulton se personat të cilët kanë kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik janë si më poshtë:

- Arber Licaj (Administrator)*
- Can Kutay Orten (Ortak)*
- Arber Licaj (Ortak)*
- Cambridge Pathology B.V (Ortak)*

MSE nuk ka deklaruar emrat e të gjithë personave të cilët kanë kompetenca përfaqësues, vendimmarrëse, apo kontrolluese, që nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për veprat penale parashikuar në nenin 76/1 të LPP.

MSE ka deklaruar vetëm disa nga emrat e këtyre personave dhe nuk ka deklaruar për të gjithë që kanë kompetenca vendimmarrëse, kontrolluese apo përfaqësuese sic është rasti i ortakut Cambridge Pathology B.V. Per nje rast te tille ne nje prokurim te ngjajshem institucioni Juaj ka kerkuar skualifikimin e ketij operatori nga procedura e prokurimit.

Sjellim në vëmendjen tuaj se person/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit mbikëqyrës, si aksionar ose si ortak që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda OE, është edhe Personi Juridik Cambridge Pathology B.V (Ortak). MSE nuk e ka deklaruar këtë person juridik nëse është i dënuar apo jo për veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP. Fillimisht duhej të deklaronin për personin juridik Cambridge Pathology B.V që nuk është i dënuar dhe në vijim duhej të deklaronin emrat e personave aksioner, ortak apo drejtor vendimmarrës të kësaj shoqërie, pra të Cambridge Pathology BV, në kushtet kur kjo shoqëri është si ortak në cilësinë e një personi juridik dhe si e tillë i linden këto detyrime që përmendëm më lart. Pra MSE nuk ka deklaruar saktë për personin juridik Cambridge Pathology BV si person me kompetenca vendimmarrëse, kontrolluese apo përfaqësuese si dhe nuk ka deklaruar emrat e personave me të njëjtat tagra brenda subjektit Cambridge Pathology BV.

Edhe në rast se ka deklaruar emrin e vetëm një personi si përfaqësues të kësaj kompanie, sjellim në vëmendjen tuaj se kompania Cambridge Pathology B.V ka disa persona të cilët kanë kompetenca vendimmarrëse, kontrolluese apo përfaqësuese. Pra nuk është i mjaftueshëm deklarimi i vetëm një personi, prandaj duhej të deklaroheshin emrat e të gjithë personave me tagra vendimmarrëse, kontrolluese apo përfaqësuese të Cambridge Pathology B.V.

Në nenin 76 kriteret detyruese për skualifikimë të ligjit nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik parashikohet shprehimisht se: 1. Cdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjecare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme: a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; c) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; dh) falsifikim; e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

Në rastin e operatorit ekonomik MSE mungon informacioni për ortakun Cambridge Pathology BV dhe personat e tjerë brenda kësaj kompanie të cilët kanë kompetenca vendimarrëse/kontrolluese apo përfaqësuese brenda këtij subjekti dhe nuk është bërë një deklaram i tillë për të gjithë personat. Pretendimet tona i bazojmë edhe referuar frymës së legjislacionit të Prokurimit Publik në përgjithësi dhe vecanarisht qëndrimin të mbajtur për të njëjtën çështje për mos plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetedeklarimit të KPP nëpërmjet Vendimit Nr 337/2024, nr prot. 263/15 datë 04.04.2024, ku KPP shprehet se AK duhet të vijojë me skualifikimin e këtij operatori ekonomikë.

Ne specifikimet teknike të kësaj procedure prokurimi nder të tjera kerkohet:

Operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisjur me autorizimin e prodhuesit për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes për pajisjet përkatëse.

Sjellim në vëmendjen tuaj se pajisjet objekt prokurimi janë të markes Philips. Për këtë procedure prokurimi, vetëm shoqëria "Health & Light" ka qenë e autorizuar nga Philips për të marrë pjesë. Kjo provohet me dokumentin autorizim prodhuesi të paraqitur nga shoqëria jone në tender. Pra, i vetmi operator i autorizuar në Shqipëri për të marrë pjesë në këtë procedure, është shoqëria "Health & Light" dhe asnjë tjetër. Në këto kushte, që KVO ka kualifikuar këtë OE, e ka kryer kualifikimin në shkëlqje të LPP pasi MSE nuk e plotëson këtë kriter. MSE nuk është i autorizuar për mirëmbajtjen e pajisjeve objekt prokurimi nga prodhuesi i pajisjeve. Nëse ka ndodhur që MSE ka paraqitur një autorizim prodhuesi, atëherë duhet të hetohet origjinaliteti i tij pasi automatikisht rezulton që ka paraqitur një dokument të falsifikuar. Për këtë çështje, ju mund të kontaktoni direkt prodhuesin, të dhenat e të cilit i gjeni në autorizimin e prodhuesit të paraqitur nga shoqëria jone "Health & Light".

Sipas zerave qe qarkullojne, nje situate e ngjashme ka ndodhur edhe ne nje procedure tjeter prokurimi ku jane paraqitur dokumente te rreme dhe pas kofirmimit nga kompania prodhuese qe dokumentet nuk jane leshuar prej saj, OE ofertues eshte terhequr nga oferta e tij duke terhequr edhe dokumentet e rreme qe ka paraqitur. Ne do te kerkonim qe te terhiqej nga ana juaj dokumentacioni i paraqitur si ne kete procedure prokurimi dhe ne ate te realizuar nga Qendra Spitalore Universitare Nene Tereza ne date 30.11.2023 (megjithese jasht objektit te kesaj ankese, por qe mendojme se transparencja ndihmon ne gjykimin Tuaj) dhe te paraqitemi per ballafaqim prane institucionit Tuaj ku gjithacka te rregjistrohet.

Ne piken 2.3.2 te DST-ve kerkohet:

Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (nje) inxhinier te trajnuar për pajisjet mjekësore të cilët do të kryejnë shërbimin e mirëmbajtjes dhe furnizim vendosjes së pjesëve të këmbimit me profil inxhinier biomjekësor/elektronik/elektrik/mekatronik/IT. Për këtë OE duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese për inxhinierin e mësipërm:

Diploma;

Certifikatat/dëshmitë e trajnimit për pajisjet objekt prokurimi, lëshuar nga kompania prodhuese ose ekuivalentet e këtyre certifikimeve lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre;

Kontratë pune/ shërbimi e vlefshme;

Listepagesat e deklaruara ne organet tatimore (formulet E-sig 025) ne tre muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit per inxhinierat bazuar në vkm nr 514 date 20.09.2017 per miratimin e listes kombetare te profesioneve.

OE MSE shpk, nuk disponon certificate trajnimi per pajisjen CT Scanner Philips te leshuar nga kompania prodhuese ose ekuivalente te saj te leshuar nga autoritete te tjera te certifikuar per dhenien e tyre kjo pasi ne politikat e saj Philips gjithmone trajnon dhe certifikon per pajisjet e prodhuara prej saj vetem inxhinieret e kompanive distributore te saj. Pra, nuk trajnon dhe as certifikon asnje inxhinier te firmave te tjera te cilat nuk jane distributore te Philips. Per sa kohe MSE nuk eshte dhe nuk ka qene ndonjehere distributor i Philips, atehere nuk ka asnje person te certifikuar per pajisjen skaner. Shtojme gjithashtu se, jemi ne dijeni te faktit qe MSE ka ne dispozicion certificate trajnimi te vlefshme per pajisjen Angiograf Philips/Allura Centron, CA pasi kete certifikim e zoteron njeri nga inxhinieret e tij i cili ka qene ish punonjes i "Health & Light" por theksojme se ky certifikim nuk eshte i vlefshem per mirembajtjen e pajises CT Scanner si dhe nuk eshte ekuivalente per mirembajtjen e tij. Ky person, nuk ka patur certifikime per mirembajtjen e skanerave asnjehere kur ishte pjese e stafit tone qe ne ishim dhe jemi distributor te Philips per Shqiperine ndersa tani qe ai punon per nje kompani qe nuk eshte distributore e Philips, nuk ka asnje mundesi per te patur nje certifikim te tillë.

Ju bejme me dije qe kete teknike te skualifikimit tone gjoja per parregullsi dhe kualifikimin e OE MSE shpk e kemi pare para disa muajsh ne procedure e zhvilluar nga Q.S.U. Nene Tereza. Te gjitha jane ne dijeni se cfare ka ndodhur me ato aparatura, ku prej kater muajsh tashme Urgjenca e Q.S.U. Nene Tereza Tirane nuk funksionon dhe po shpenzohen shuma te konsiderueshme nga buxheti per te rivene ne pune urgjencen dhe pajisjet e demtuara.

Rrjeshimisht, ne permbledhje te gjitha sa thame me siper, kerkojme:

- kualifikimin e OE "Health&Light" shpk si e vetmja oferte qe ploteson te gjitha kriteret e kualifikimit dhe specififikimet teknike me cmimin me te ulet;*
- skualifikimin e OE "MSE" shpk per mospermbushje te kriterëve te kualifikimit te parashikuara ne DST ;*
- kerkojme te behet verifikimi i te gjitha dokumentacionit te paraqitur nga "MSE", hetimi administrativ per kete procedure dhe referimi i kesaj ceshtjeje ne APP per perjashtimin e "MSE" nga e drejta per te marre pjese dhe per te perfituar procedura te prokurimit publik.*

II.7. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik" Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 1592/2 prot., datë 18.06.2024 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik "Health & Light" SHPK, si dhe kriteret të cilat pretendohen se nuk përmbushen nga operatori ekonomik "MSE" SHPK, që kundërshton ankimuesi me anë të ankesës me nr. 1592/2024 prot., datë 14.06.2024.

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik ankimues "Health & Light" SHPK ka dorëzuar nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike argumente të cilat janë protokolluar pranë KPP-së me shkresës nr. 1592/3 prot, datë 19.06.2024.

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se subjekti i inetersuar "MSE" SHPK ka dorëzuar nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike argumente të cilat janë protokolluar pranë KPP-së me shkreen nr. 1592/4 prot, datë 24.06.2024, sipas parashikimeve në nenin 113 të LPP-së.

II.10. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik ankimues "Health & Light" SHPK ka dorëzuar nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike argumente të cilat janë protokolluar pranë KPP-së me shkresën nr. 1592/6 prot, datë 28.06.2024.

II.11. Nëpërmjet shkresës me nr. 1567/7 prot., datë 25.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 1592/5 prot., datë 25.06.2024, me objekt "Kthim Përgjigje" (ardhur nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike) dhe shkresës nr. 1567/7 prot., datë 25.06.2024, protokolluar me tonën

me nr. 1592/7 prot., datë 28.06.2024 me objekt “Kthim Përgjigje”, është depozituar nga autoriteti kontraktor akti i trajtimit të ankesës nga verifikimi i të cilit konstatohet se autoriteti kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes “Health & Light” SHPK si më poshtë vijon:

Bazuar ne shkresën nr. 1576/3 prot date 19.06.2024, Per shqyrtimin e ankeses se bere nga operatori ekonomik “Health & Light”, protokolluar prane SRSH me nr. 1576/1 prot, date 14.06.2024 per proceduren e prokurimit LOT 1 me objekt: “Mirembajtja Full Risk e pajsieve mjekesore Philips me fond limit 23, 108,800 leke pa tvsh me numer Reference REF - 01574-04-16-2024.

-Objekt i ankeses:

Ne piken 2 te formularit te ankeses nuk eshte cekuar asnje nga alternativat e objektit te ankeses, as nuk eshte cituar ndonje objekt tjetër...

Spitali Rajonal Shkoder ka zhvilluar proceduren e prokurimit me objekt: “Mirembajtja Full Risk” e pajsieve mjekesore Philips me fond limit 23,108,800 leke pa tvsh me numer Reference REF -01574-04-16-2024.

-Autoriteti Kontraktor ne Kriteret e kualifikimit ka kerkuar:

2.3.3. Nje deklarate qe merr persiper kryerjen e mirembates te tipit Full Risk sipas specifikimeve teknike per pajisjet objekt prokurimi dhe te gjithë aksesoreve te cilat jane të lidhura me pajisjen.

2.3.4. Nje deklarate qe merr persiper zevendesimin e pjesëve te kembimit dhe konsumit, te cilat do te jene originale ose ekuivalente dhe ne perputhje me ato te perdorura fillimisht (te garantuara nepermjet certifikimit CE ose FDA) dhe qe perfshihen ne vleren e kontrates. Garancia e pjeseve te kembimit do te jete per nje periudhe jo me pak se nje vit nga momenti i levrimit.

2.3.7. Nje deklarate qe pranon oraret e kryerjes se sherbimeve, shpejtesine e nderhyrjeve dhe inspektimin e sigurise.

Nga verifikimi i dokumentacionit te ngarkuar ne sistem nga operatori ekonomik rezulton se:

Ju keni ngarkuar ne sistem gjithë dokumentacionin e procedures me daten 07.05.2024 qe perkon me daten e hapjes se procedures si:

- Formular oferte date 07.05.2024*
- Liste mimesh date 07.05.2024*

Ndersa deklaratat sipas pikes 2.3.3,2.3.4 ,2.3.7 mbajne daten 03.05.2024.

- *Ne deklaratën e sjelle për përmbushjen e pikës 2.3.7, ju nuk jeni shprehur që pranoi inspektimin e sigurisë.*

Pas shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "Health & Light", bazuar në ligjin nr. 162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", nëni 114/3 pika c dhe VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar nëni 102/1 pika c.

Vendos

Refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "Health & Light".

II.12. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se janë dorëzuar argumente në sistemin e ankesave elektronike nga subjekte të interesuara, sipas parashikimeve në nenin 113 të LPP-së.

Arsyeton:

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik "Health & Light" SHPK se: "Data e deklaratave (pika 2.3.3, 2.3.4, 2.3.7) të DST-së nuk është data e zhvillimit të procedurës (07.05.2024)", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8/2 "Kriteret e veçanta të kualifikimit", pika 2.3.3, 2.3.4 dhe 2.37 "Kapaciteti teknik", të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

2.3.3. *Një deklaratë që merr përsipër kryerjen e mirëmbajtjes të tipit Full Risk sipas specifikimeve teknike për pajisjet objekt prokurimi dhe të gjithë aksesoret të cilat janë të lidhura me pajisjen.*

2.3.4. *Një deklaratë që merr përsipër zëvendësimin e pjesëve të këmbimit dhe konsumit, të cilat do të jenë origjinale ose ekuivalente dhe në përputhje me ato të përdorura fillimisht (të garantuara nepermjet certifikimit CE ose FDA) dhe që përfshihen në vlerën e kontratës. Garancia e pjesëve të këmbimit do të jetë për një periudhë jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit.*

2.3.7. *Një deklaratë që pranon oraret e kryerjes së shërbimeve, shpejtësinë e ndërhyrjeve dhe inspektimin e sigurisë.*

III.1.2. Në përmbushje të kriterit më sipër cituar, operatori ekonomik "Health & Light" SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

1- Deklaratë për kryerjen e mirëmbajtjes “Full Risk” si më poshtë vijon:

Health & Light Sh.p.k
Rruga “Themistokli Gërmenji”, Nd. 11
Shkalla 4, Kati 2, Ap.4
Tirane, Shqiperi
Nipt: L42231011L



Data 03/05/2024

DEKLARATE PËR KRYERJEN E MIRËMBAJTJES “FULL RISK”

Referuar procedurës me objekt prokurimi: Mirembajtje (full risk) e pajisjeve të medha mjekesore për një periudhë 24 mujore e ndarë në lote, Lot.1 “Mirëmbajtja “full risk” e pajisjeve mjekësore të prodhuesit Philips” me fond limit:23,108,800 (njetzet e tremiljon e njeqind e tetemije e eteteqind) lekë pa tvsh REF – 01574-04-16-2024, nëse shpallemi fitues, marrim përsipër kryerjen e mirëmbajtjes të tipit Full Risk sipas specifikimeve teknike për pajisjet objekt prokurimi dhe të gjithë aksesorëve të cilat janë të lidhura me pajisjen.

Me respekt

2- Deklaratë për pjesët e këmbimit si më poshtë vijon:

Health & Light Sh.p.k
Rruga “Themistokli Gërmenji”, Nd. 11
Shkalla 4, Kati 2, Ap.4
Tirane, Shqiperi
Nipt: L42231011L



Data 03/05/2024

DEKLARATE PËR PJESËT E KËMBIMIT

Referuar procedurës me objekt prokurimi: Mirembajtje (full risk) e pajisjeve të medha mjekesore për një periudhë 24 mujore e ndarë në lote, Lot.1 “Mirëmbajtja “full risk” e pajisjeve mjekësore të prodhuesit Philips” me fond limit:23,108,800 (njetzet e tremiljon e njeqind e tetemije e eteteqind) lekë pa tvsh REF – 01574-04-16-2024, nëse shpallemi fitues, marrim përsipër zvendesimin e pjesëve të këmbimit dhe konsumit. Ato do jenë të reja origjinale ose ekuivalente dhe në përputhje me ato të përdorura fillimisht (të garantuara nepërmjet certifikimit CE ose FDA) dhe që përfshihen në vlerën e kontratës dhe se garancia e pjesëve të këmbimit do të jetë për një periudhë prej një viti nga momenti i lëvrimit.

Me respekt

3- Deklaratë për oraret e kryerjes së shërbimeve si më poshtë vijon:

Health & Light Sh.p.k
Rruga “Themistokli Gërmenji”, Nd. 11
Shkalla 4, Kati 2, Ap.4
Tirane, Shqiperi
Nipt: L42231011L



Data 03/05/2024

DEKLARATE PËR ORARET E KRYERJES SË SHËRBIMEVE

Referuar procedurës me objekt prokurimi: Mirembajtje (full risk) e pajisjeve të medha mjekesore për një periudhë 24 mujore e ndarë në lote, Lot.1 “Mirëmbajtja “full risk” e pajisjeve mjekësore të prodhuesit Philips” me fond limit:23,108,800 (njetzet e tremiljon e njeqind e tetemije e eteteqind) lekë pa tvsh REF – 01574-04-16-2024, deklarojmë nën përgjegjësinë tonë personale që pranojmë oraret e kryerjes së shërbimeve dhe shpejtësinë e ndërhyrjeve.

Me respekt

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.1.5. Në nenin 77, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet

kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësor.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë

pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton dhe kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantojë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë se zotërojnë makineritë dhe pajisjet e duhura për zbatimin me sukses të kontratës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “*Health & Light*” SHPK, në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit, të parashikuar në shtojcën 8/2 pika 2.3.3; 2.3.4; 2.3.7 në lidhje deklaratat, Komisioni vëren se ky i fundit ka paraqitur në sistemin e prokurimeve publike SPE deklaratat e shkrehura në pikën III.1.2 të këtij vendimi në të cilën konstatohet se mbajnë datën 03.05.2024, ndërkohë që procedura e prokurimit është zhvilluar në datë 07.05.2024, datë kjo e fundit për dorëzimin e ofertave dhe dokumentacionit shoqërues të ofertës në SPE, ç’ka do të thotë se dokumentacioni i sipërcituar në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi ka qenë i vlefshëm, pra afati i vendosur në deklaratat e sipërcituara përkon me datën e ngarkimit të dokumentacionit në SPE datë kjo përpara datës së përcaktuar për dorëzimin e ofertave. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimes ka paraqitur dokumente të vlefshme në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, për të përmbushur kriteret dhe përcaktimet e autoritetit kontraktor, pasi *vetëdeklarimet e operatorit ekonomik* nga verifikimi rezulton se ato nuk e kanë humbur vlefshmërinë në datën 07.05.2024, datë në të cilën autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit. Në këto kushte, Komisioni gjykon se operatori

ekonomik ankimues ka paraqitur dokumente të vlefshme në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, për të përmbushur kriteret dhe përcaktimet e autoritetit kontraktor në dokumentet standarde të tenderit. Në këtë mënyrë, KPP referuar pretendimit të autoritetit kontraktor, pasi kreu verifikimet e dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “*Health & Light*” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion në përputhje me kriterin e kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit. Sa më sipër konstatuar Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se operatori ekonomik ankimues ka mundur të paraqesë në këtë procedurë prokurimi dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit sa i përket vlefshmërisë së *deklaratave* të cilat në datën e zhvillimit të procedurës nga autoriteti kontraktor me 07.05.2024, kanë qenë të vlefshme duke dëshmuar kështu, se plotëson kriterin në fjalë, si dhe duke garantuar autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Kështu, autoriteti kontraktor nuk mund të gjykojë a-priori dhe në mënyrë sipërfaqësore, por të analizojë në themel dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në garë.

III.1.8. Vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor disponon të gjitha elementet e nevojshme procedurale, si garanci, në rast të shkeljes së kontratës, konkretisht nenin 124 “*Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës*” të Ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” dhe nenin 36 “*Sigurimi i kontratës*”, dhe nenin 108 “*Raportimi në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale*” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në bazë të nenit 124 “*Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës*” të LPP-së, si dhe nenit 36 “*Sigurimi i kontratës*”, dhe nenit 108 “*Raportimi në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale*” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e punimeve do të jetë e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të ligjit dhe rregullave për prokurimin publik, si më sipër cituar. Operatori ekonomik “*Health & Light*” SHPK, me anë të dokumentacionit të paraqitur, vërteton se plotëson me sukses kriteret kualifikuese në dokumentet standarde të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*Health & Light*” SHPK qëndron.


III.2. Lidhur me arsyen e kualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “*Health & Light*” SHPK se: “*Deklarata (pika 2.3.7 e DST-së) jo e plotë*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8/2 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pika 2.37 “*Kapaciteti teknik*”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

2.3.7. *Një deklaratë që pranon oraret e kryerjes së shërbimeve, shpejtësinë e ndërhyrjeve dhe inspektimin e sigurisë.*

III.2.2. Në përmbushje të kriterit më sipër cituar, operatori ekonomik “*Health & Light*” SHPK, ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

1- Deklaratë për oraret e kryerjes së shërbimeve si më poshtë vijon:



III.2.3. Në nenin 2 “*Qëllimi i ligjit*” të ligjit nr. 162/2021 “*Për prokurimin publik*” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.2.4. Në nenin 3 “*Parime të përgjithshme*” të ligjit nr. 162/2021 “*Për prokurimin publik*” parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose*

dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.5. Në nenin 77, pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme

njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit 2.3.7 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, si më sipër cituar,

operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar deklaratën e cituar në pikën III.2.2. të këtij vendimi. Referuar raportit të auditit në SPE, Komisioni konstaton, se nga ana e KVO nuk janë dhënë shpjegime në mënyrë shteruese, lidhur me mospërmbushjen e kriterit 2.3.7 nga ana e operatorit ekonomik ankimues, por thjesht është vendosur “*Deklarata (pika 2.3.7 e DST-së) jo e plotë*”, pa përcaktuar në mënyrë shteruese se çfarë i mungon kësaj deklaratë. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, e më konkretisht, kthim përgjigjes nr. 1567/7 prot, datë 25.06.2024 të KSHA-së, mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, KPP konstaton, se prej kësaj të fundit janë dhënë shpjegime në mënyrë të detajuar, lidhur me mospërmbushjen nga ana e ankimuesit të këtij kriteri kualifikimi.

Referuar vlerësimit të KVO për kriterin 2.3.7, ankesës së operatorit ekonomik ankimues lidhur me kundërshtimin e bërë vendimit të KVO, për mospërmbushjen e këtij kriteri kualifikimi, si dhe argumenteve të dhëna nga KSHA, Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimues me mënyrën se si KVO ka kryer vlerësimin e tij lidhur me këtë kriter, ka qenë në padijeni të arsyes konkrete/specifike të mospërmbushjes së kriterit 2.3.7, duke mos pasur mundësi të ngrejë pretendime lidhur me këto arsye skualifikimi.

Sa më sipër KPP gjykon, se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, si përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, në përputhje me parashikimet e nenit 75 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, duhet të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik ankimues, lidhur me kriterin 2.3.7 dhe nëse është rasti për refuzim, të pasqyrojë në mënyrë të qartë dhe shteruese arsyet e refuzimit në SPE. Vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor, ka detyrimin që në zhvillimin e procedurave të prokurimit të zbatojë me përpikëri të gjitha parashikimet ligjore, më qëllim mosdiskriminimin dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*Health & Light*” SHPK qëndron pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*Health & Light*” SHPK mbi kualifikimin e shoqërisë “MSE” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim pasi, referuar gjyqimit mësipër në pikën III.2.6., Komisioni ka urdhëruar komisionin e vlerësimit të ofertave që të rivlersojë procedurën e prokurimit përsa i përketë arsyes së skualifikimit të operatorin “*Health & Light*” SHPK jo të qartë dhe jo shteruese, dhe gjendja faktike dhe juridike e këtij operatori ekonomik nuk do të ndryshojë në këtë fazë procedurale, ndaj dhe pretendimet e ngritura për operatorin ekonomik “MSE” SHPK në këtë moment procedural nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative, për sa kohë që procedura e prokurimit objekt-ankimi do të rikthehet për rivlersim vetëm për operatorin ekonomik ankimues “*Health & Light*” SHPK përsa i përketë arsyes për mospërmbushje të kriterit 2.3.7, për shkak se autoriteti kontraktor nuk ka ndjekur hapat proceduralë që i ngarkon ligji për vlerësimin e operatorit ekonomik “*Health & Light*” SHPK, duke mos u shprehur në mënyrë të qartë dhe shteruese. Gjendja faktike dhe juridike e operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës nuk duhet të ndryshojë nga ajo e datës 31.05.2024, edhe pas vlerësimit që do të kryhet nga ana e autoritetit kontraktor në zbatim të

këtij vendimi. Operatori ekonomik ankimues ka të drejtë sërish për të kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor pas rivlerësimit.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “*Health & Light*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedura e Hapur*”, me REF-01574-04-16-2024, me objekt Loti 1 “*Mirëmbajtja “full risk” e pajisjeve mjekësore të prodhuesit Philips*”, me fond limit 23,108,800 (njëzet e tre milion e njëqind e tetë mijë e tetëqind) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 07.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Shkodër.
 2. Autoriteti kontraktues të kryejë rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në këtë vendim.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vëre në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Health & Light*” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

